

# Vaksinimi mbrojtës kundër koronës – i sigurt dhe efikas!

Data: 21 qershor 2021

Vaksinimi ju mbron nga një infektim i koronavirusit. Koronavirusi shkakton sëmundjen COVID-19. COVID-19 mund të kalohet lehtë. Të infektuarit ankohen për kollë, temperaturë, rrufë dhe dhimbje fyti. Por ka edhe sëmundje më të rënda. Të infektuarit nuk mbushen dot më me frymë. Ose sëmuren nga një infeksion në mushkëri.

Deri në mes të qershorit 2021  
kanë vdekur mbi **90 000**  
**persona** nga ose me COVID-19  
në Gjermani.

## Vaksinimi mbrojtës kundër koronës është i sigurt

Vaksinat në Gjermani janë të sigurta. Kjo vlen për të gjitha vaksinat, por edhe për vaksinat kundër koronës.

- Vaksinat testohen plotësisht para se të mund t'i përdorin. Edhe pas miratimit të tyre, vaksinat kontrollohen sërish. Merren parasysh gjetjet e reja.
- Është normale nëse trupi reagon pas vaksinimit. Mund të keni dhimbje në vendin ku jeni shpuar. Ose ndiheni të lodhur dhe të dobët. Madje temperatura dhe ethet janë normale. Këto ankesa zhduken sërish pas 2, 3 ditëve.
- Shumë rrallë ka edhe efekte të tjera anësore. Këto efekte të tjera anësore mund të jenë për shembull dhimbjet e forta të kokës. Nëse efektet anësore nuk zhduken pas disa ditëve, shkoni te mjekja apo mjeku juaj i familjes.
- Nuk ka të dhëna që vaksinimi shkakton dëmtime afatgjata. Gjithashtu vaksinimi nuk ndikon në aftësinë për të bërë fëmijë.

## Vaksinimi mbrojtës kundër koronës është efikas

Vaksinimi garanton që trupi të krijojë imunitet. Prandaj jeni të mbrojtur mirë nga sëmurja e rëndë. Megjithatë ekziston një rrezik i vogël që të sëmureni sërish nga COVID-19. Prandaj, është e rëndësishme t'i përmbaheni rregullit **DHP+A (Distancë-Higjienë-Përditshmëri + Ajrim)**:

- Mbani **d**istancë
- Lani duart / Kujdesuni për **h**igjienën, d.m.th. kollituni ose teshtini në cepin e kraut ose përdorni një shami.
- Mbani maskë në **p**ërditshmërinë tuaj
- **A**jrosni rregullisht

## Ja si mund të vaksinoheni

Vaksinimi është me dëshirë dhe falas. Ju mund të vaksinoheni

- Në klinika mjekësore
- Në qendra vaksinimi
- Nga ekipet e lëvizshme të vaksinimit

Do të vaksinoheni nga mjekët ose personeli mjekësor. Ju duhet një **takim për vaksinimin**. Për vaksinimin mund të informoheni në [www.116117.de](http://www.116117.de) ose në **numrin e telefonit 116117**.



# Vaksinimi mbrojtës kundër koronës – ja si funksionon:



## Regjistrimi

- Botimi i fletës së informacionit
- Botimi i pyetësorit mbi historinë personale mjekësore



## Pritja

- Lexoni fletën e informacionit
- Plotësoni pyetësin



## Biseda sqaruese

- Informacion mbi reaksionet e mundshme të vaksinës dhe efektet anësore
- Sqarimi i pyetjeve
- Firmosja e formularit të pëlqimit



## Vaksinimi

- Injektimi i vaksinës në pjesën e sipërme të krahut



## Pritja

- 15–30 minuta ndjekje pas vaksinimit
- Nëse ka reaksione alergjike ose probleme me sistemin e qarkullimit, atëherë këto mund të trajtohen menjëherë nga mjeku.



## Largimi

- Dhënia e kartës ose certifikatës së vaksinimit